

L I G J
Nr. 8951, datë 10.10.2002

PËR NUMRIN PERSONAL TË SHTETASVE

(Ndryshuar me ligjin nr. 2, datë 26.1.2012)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

(Ndryshuar togfjalësh me ligjin nr. 2, datë 26.1.2012)

Qëllimi i ligjit është përcaktimi i kuptimit, mënyrës së formimit dhe sferës së përdorimit të numrit personal, si një nga përbërësit e veçantë të gjendjes civile, i cili përcakton dhe shërben për identifikimin e shtetasve shqiptarë, personave pa shtetësi dhe shtetasve të huaj me qëndrim të përhershëm brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

(Ndryshuar togfjalësh në pikën 1 dhe 2 me ligjin nr. 2, datë 26.1.2012)

1. Numri personal është unik dhe vendoset nga shërbimi i gjendjes civile. Ai përbëhet nga dhjetë elemente me informacion të koduar dhe ka strukturën e mëposhtme:

Elementi 1-2 viti i lindjes

Elementi 3-4 muaji i lindjes dhe seksi

Elementi 5-6 data e lindjes

Elementi 7-9 numri serial brenda së njëjtës datë

Elementi 10 element kontrolli.

2. Numri personal lëshohet nga shërbimi i gjendjes civile.

Neni 3

(Ndryshuar togfjalësh në fjalinë hyrëse dhe pika 2, shfuqizuar pika 4 me ligjin nr. 2, datë 26.1.2012)

Numri personal shërben:

1. Për Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

2. Për letërnjoftimin.

3. Si numër i sigurimit shoqëror për të identifikuar, regjistruar dhe për të kërkuar përfitime nga sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe për programet e tjera të mbrojtjes shoqërore.

4. Shfuqizuar.

5. Për sistemin tatimor.

6. Për dëshminë e aftësisë së drejtimit të automjeteve.

7. Për nevojat e organeve dhe të institucioneve të tjera shtetërore, si organeve të drejtësisë, të rendit, të prokurorisë, të mbrojtjes, të arsimit dhe të Zyrës së Regjistrimit të Pasurisë.

Neni 4

(Ndryshuar togfjalësh me ligjin nr. 2, datë 26.1.2012)

Mënyra e kodimit të numrit personal, masat dhe detyrat e organeve shtetërore për pajisjen e shtetasve me numër personal, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5

Paragrafët e parë dhe të dytë të nenit 1, nenet 2, 3, 6, 7, si dhe paragrafi i tretë i nenit 13 të ligjit nr.7845, datë 13.7.1994 “Për numrin e sigurimit shoqëror”, shfuqizohen.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 12 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 3541, datë 7.11.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**